



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 706/4 Prot.

Tiranë, më 05.07.2023

V E N D I M

Nr. 124, Datë 05.07.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 129, datë 22.06.2023, e Qendrës “Shtëpia Orthodhokse e Shpresës” kundër Gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë, Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë, A.B, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “shtetësisë”, “bindjes fetare”, “moshës” dhe “pamjes së jashtme”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Në datë 06.06.2023, në orën 13:00, në cilësinë e palës së tretë jemi thirrur për t’u dëgjuar në çështjen gjyqësore me objekt: “Caktim Kujdestarie”. Ne jemi një shtëpi e kujdesit për të mitur dhe e licencuar sipas kuadrit ligjor në fuqi të Shtetit Shqiptar. Nisur nga kjo, ndonëse kemi certifikatë regjistrimi dhe monitorohemi në mënyrë periodike nga institucionet përkatëse, kurrë më parë nuk jemi njohur me një gjuhë diskriminuese, ku shkak bëhet pikërisht besimi fetar që financon mbarëvajtjen e këtij institucioni për mirërritjen e këtyre fëmijëve.

E gjitha nisi nga një proces gjyqësor i iniciuar nga Shtëpia e Foshnjës “.....” Tiranë, e cila kërkonte kalimin e kujdestarisë së njërit prej fëmijëve të dërguar tek ne.

U paraqitëm dhe me punonjësen tonë sociale, për të cilën nisi fillimisht për shkak të pamjes së saj (sipas Diskriminuesit, ishte e vogël) duke ndikuar në qëndrimin tonë.

Me një etikë jo institucionale, e as gjyqësore, ligjore as që mund të diskutohet, u gjendëm befas të sulmuar për shkak të emërtesave të këtyre institucioneve fillimisht, e mandej për shkak të parashikimeve statutores, që parashikon ndër të tjera dhe korniza të caktuara fetare, që në asnjë moment nuk janë indoktrinuese, e aq më pak imponuese.

Ndonëse ishim paraqitur për t'u dëgjuar si palë e interesuar, u shenjësruam për gati një orë nga ky gjyqtar që duhet të garantonte ligjshmërinë në proces, si dhe të respektonte garancitë e tjera Kushtetuese. Nuk garantoi asgjë tjetër veçse një gjuhë jo gjyqësore, fyese duke na shkaktuar një gjendje të pashpjegueshme të të ndjerit keq. Një sulm verbal i paarsyeshëm nga një gjyqtar. Ky gjyqtar i cili me arrogancë nisi shigjetat e vazhdueshme të diskriminimit jo vetëm për faktin se "Shtëpia Orthodhokse Shpresa" është një institucion nën përkujdesjen e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, por me një gjuhë diskriminuese vijoi fyerjet ndaj drejtuesve të lartë të këtij institucioni fetar, duke i identifikuar shpesh herë si "këto grekë janë?", apo duke mbajtur qëndrime antifetare kur thoshte: "paskeni dhe parime biblike/ju indoktrinoni/pse nuk i çoni në xhami fëmijët dhe t'u mësoni ligjet e Sheriatit por i dërgoni në kishë", etj.

Qartësisht ky gjyqtar ka shkelur ndër të tjera dhe rregullin IV dhe V të Kodit të Etikës Gjyqësore (2006), ku shprehimisht thuhet respektivisht se: "Gjatë punës së tij gjyqtari duhet të shmangë çdo sjellje të papërshtatshme dhe që bie në kundërshtim me ligjin, kodin e etikës, si dhe veprime që mund të dëmtojnë ose të hedhin dyshime mbi figurën e tij morale". Rregulli V përcakton se: "Gjyqtari gjatë ushtrimit të funksioneve të tij gjyqësore duhet të shmangë njëanshmërinë dhe paragjykimet për shkaqe që lidhen me racën, seksin, besimin fetar, kombësinë, gjendjen social-ekonomike, moshën, paaftësinë mendore ose fizike, e shkaqe të tjera që lidhen me palët në proces. Një gjë të tillë nuk duhet t'ia lejojë as palëve në proces, as nëpunësve gjyqësor dhe atyre që i nënshtrohen urdhrave dhe kontrollit të gjykatës".

Këto rregulla kaq të rëndësishme jo vetëm nuk u respektuan por u shkelen dhe na kthyen në subjekte të diskriminuara. Vlen të theksojmë se seanca gjyqësore në fjalë nuk u zhvillua në një sallë gjyqësore, por në zyrën e gjyqtarit, duke krijuar më tej një klimë tensioni në paraqitjen e qëndrimeve tona. Aty u diskutua për besimin fetar, u diskutua për kombësitë e drejtuesve të këtij Institucioni Fetar, u diskutua për emrat e tyre nëse janë grekë apo shqiptarë, u diskutua për moshën e punonjësve sonë sociale, për ta vendosur në pozita inferioriteti, vetëm për objektin e çështjes nuk u diskutua. Sigurisht që ne respektojmë sistemin tonë gjyqësor, e promovojmë atë, mendojmë dhe vlerësojmë se është një burim drejtësie. Viojmë të mendojmë kështu, por nuk mbajmë këtë qëndrim për Gjyqtarin A.B, ndaj të cilit do ndërmarim dhe veprime të tjera ligjore, si përjashtimi i tij si gjyqtar i kësaj çështje gjyqësore".

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, t'i drejtojë Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pezullimin e Gjyqtarit A.B nga detyra ose minimalisht përjashtimin e tij si gjyqtar që shqyrton këtë çështje gjyqësore.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohe të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Subjekti ankues, ka ngritur pretendime ndaj A.B, Gjyqtar, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë, lidhur me etikën e komunikimit të gjyqtarit ndaj palës ankuese.

Neni 135, pika 1 e Kushtetutës, bën dallimin midis gjyqtarëve sipas funksioneve dhe në të njëjtën kohë kërkon t'i shkëpusë ata nga varësia hierarkike dhe ia nënshtrojnë veprimtarinë e tyre në dhënien e drejtësisë, vetëm kontrollit të instancave më të larta gjyqësore, sipas rregullave të përcaktuara në kodet e procedurave.

Në nenin 145, të Kushtetutës, sanksionohet se, gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke nënkuptuar kështu, pavarësinë, përgjegjësinë dhe kompetencat e veçanta të gjyqtarit në dhënien e drejtësisë. Në nenin 147, pika 1 e Kushtetutës, përcaktohet se: *“Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*.

Në nenin 86 të ligjit nr. 115, datë 03.11.2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, përcaktohet se: *“Në zbatim të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për çështjet e mëposhtme në lidhje me të gjithë gjyqtarët, përveç gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese: a) emërimin; b) caktimin në pozicion; c) transferimin; ç) ngritjen në detyrë; d) komandimin dhe riemërimin; dh) vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale; e) vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin; ë) çdo detyrë tjetër e caktuar me ligj”*.

Në nenin 194/1 të ligjit nr. 115, datë 03.11.2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, përcaktohet se: *“Inspektorati i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”*.

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, në nenin 74 të tij ka përcaktuar procedurën për përjashtimin e gjyqtarit, në të cilën parashikohet se: *“Në rastet kur është e detyrueshme heqja dorë e gjyqtarit, secila nga palët mund të kërkojë përjashtimin e tij.*

Kërkesa e nënshkruar nga pala përkatëse ose nga përfaqësuesi i saj, duhet të depozitohet në sekretarinë e gjykatës kur është bërë i ditur emri i gjyqtarit apo gjyqtarëve që shqyrtojnë çështjen dhe në rastin e kundërt menjëherë pas shpalljes së gjyqtarit apo gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjen.

Paraqitja e mëvonshme e kërkesës lejohet vetëm kur pala ka marrë dijeni më vonë për shkakun e përjashtimit ose kur gjatë ushtrimit të funksioneve, gjyqtari ka shfaqur mendim të njëanshëm e në mënyrë të papërshtatshme mbi faktet dhe rrethanat objekt gjykimi, por sidoqoftë jo më vonë se tri ditë nga marrja dijeni.

Kërkesa duhet të përmbajë shkaqet e përjashtimit, dokumentet e provat e tjera që disponohen”.

Në këtë kontekst, Komisioneri, vëren se gjykata është i vetmi organ që vendos lidhur me vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të gjyqtarit dhe pretendimi i subjektit ankues, për sjelljen jo etike të gjyqtarit lidhur me çështjen që është në shqyrtim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë, mund të zgjidhet vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor ose duke iu drejtuar Këshillit të Lartë të Gjyqësor¹ apo Inspektorit të Lartë të Drejtësisë², të cilët janë organet kompetente të caktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për shqyrtimin e ankesave.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e çështjeve që janë kompetencë e organeve gjyqësore, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj³.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b), ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e ankuesit për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1, germa a), nenin 33, pika 4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

¹ Neni 147/a, i Kushtetutës, përcakton ndër të tjera, se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve; b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve”.

² Neni 147/d, i Kushtetutës, përcakton ndër të tjera, se: “Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”.

³ Për analogji citojmë Vendimet nr. 132, datë 04.07.2022, nr. 97, datë 23.05.2022 dhe nr. 54, datë 11.04.2023, të KMD-së.

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 129, datë 22.06.2023, të paraqitur nga Qendra “Shtëpia Orthodhokse e Shpresës”, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA